

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9900, DATË 10.04.2008 “PËR REZERVAT MATERIALE TË SHTETIT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ndryshimi i propozuar në këtë projektligj ka për qëllim të thjeshtojë procesin e lëvrimit të mallrave rezervë shteti të grupit A, duke e zëvendësuar miratimin e lëvrimit të tyre me vendim të Këshillit të Ministrave me një akt individual “urdhër të Kryeministrit”.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA POLITIKE

Në programin analitik të projektakteve, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 764, datë 27.12.2018 “Për miratimin e programit analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019”, projektligji është parashikuar për shqyrtim në periudhën e katërmujorit të parë të vitit 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimi i propozuar në këtë projektligj ka për qëllim të thjeshtojë procesin e lëvrimit të mallrave rezervë shteti të grupit A. Ligji aktual përcakton se:

- lëvrimi i mallrave të grupit A bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave;
- lëvrimi i mallrave rezervë të grupit B bëhet me urdhër të ministrit, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit;
- mallrat rezervë të grupit C lëvrohen me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit.

Sikurse shihet lëvrimi i mallrave të grupit B dhe C bëhet me anë të një akti individual “urdhër ministri” dhe “urdhër i drejtorit të përgjithshëm”. Kjo mënyrë e bën më të lehtë dhe më të shpejtë lëvrimin e mallrave të grupeve përkatëse, sipas kushteve dhe rrethanave të parashikuara ligjërisht.

Për shkak se miratimi i lëvrimit të mallrave të grupit A bëhet nëpërmjet një akti kolegjal, si ai i vendimit të Këshillit të Ministrave, kjo sjell vonesa në daljen e aktit të miratimit dhe deri lëvrimin e tyre.

Gjithashtu, ndryshimi i propozuar ka për qëllim unifikimin e procedurës së lëvrimit të mallrave rezervë shteti, të secilit grup nëpërmjet një akti individual hierarkik, duke filluar nga drejtori i përgjithshëm - ministri dhe Kryeministri.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit” është në përputhje me Kushtetutën dhe në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNITAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrim me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, përmban 2 nene.

Në nenin 1 është parashikuar ndryshimi në nenin 10, të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”.

Konkretisht lëvrimi i mallrave rezervë shteti të grupit A të bëhet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

Ndryshimi i propozuar synon të unifikojë praktikën e miratimit të lëvrimit të mallrave rezervë shteti, sipas grupimeve përkatëse, nëpërmjet akteve normative individuale “urdhër” duke nisur nga drejtori i përgjithshëm për mallra të grupit C, nga ministri për mallra të grupit B dhe nga Kryeministri për mallra të grupit A.

Gjithashtu, projektligji i propozuar synon të thjeshtëzojë procedurën për miratimin e lëvrimit të mallrave për grupin A, nga nja akt kolegjal nëpërmjet një akti individual të Kryeministrit me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

Neni 2 i projektligjit përcakton hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e projektaktit kanë marrë pjesë drejtoritë operative të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe u dërgua për mendim në Ministrinë e Drejtësisë e cila, me shkresën nr. 3058, datë 05.04.2019, shprehet dakord për miratimin e projektaktit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMET BUXHETORE

Ndryshimet e propozuara në projektvendim janë ndryshime teknike dhe nuk paraqesin efekt financiar shtesë për buxhetin e shtetit.

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Olta Xhaçka